



VENDIM

Nr. 1, Datë 16.01.2012

**PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “KESH” SH.A PËR
TRANSFERIMIN E ASETVEVE PËRKATËSISHT “NËNSTACIONI
LANABREGAS”; “NËNSTACIONI BOGOVË”; “NËNSTACIONI
GJANÇ”; “NËNSTACIONI BUSHAT 110/20KV”; “RRJETI 20 KV
KOPLIK”; “NËNSTACIONI SHKODËR 110/20KV”; “NËNSTACIONI
FIER 110/20KV”; “NËNSTACIONI GJIROKASTËR”, “NËNSTACIONI
110/20 KV SARANDË” TEK SHOQËRIA CEZ SHPËRNDARJE SH.A**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 7, 10 pika 1 dhe nenit 11 të Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Liçensuarit, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të liçensës “Për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.01.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të asetëve nga shoqëria KESH sh.a tek Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Liçensuarit si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 Emri dhe adresa e plote e të liçensuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.)
- Neni 7, pika 1.3, gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, Përshkrimi i të liçensuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)
- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)



Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a, ”Për transferimin e asetëve, përkatësisht të: “Nënstacionit Lanabregas”; “Nënstacionit Bogove”; “Nënstacionit Gjanç”; “Nënstacionit Bushat 110/20kv”; “Rrjetit 20 Kv Koplík”; “Nënstacionit Shkodër 110/20Kv”; “Nënstacionit Fier 110/20Kv”; “Nënstacionit Gjirokastër”, “nënstacioni 110/20 kv Sarandë” tek shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.